

VENDIM
Nr. 212, datë 8.10.2021

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SUBJEKTIT “DEPA COMMERCIAL” SA PËR
APLIKIM NË TAP AG, PËR FAZËN JO TË DETYRUESHME NË TREG - TESTI I
TAP AG, PËR KAPACITETIN DHE LIDHJEN**

Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 13; 15, pika 1, germa “a”; 16, pika 24, 25; 17, pika 4; 19, pika 5 dhe të nenit 108, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të vendimit nr. 122, datë 11.5.2021, të Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e propozimit të projektit TAP, SRG dhe DESFA, për procesin e rritjes së kapacitetit, për vitin 2019”; të seksionit 4.7, pika 9, të “Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë”, korrik 2013; të opinionit 1/2013, të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë datë 14 maj 2013, “Mbi përjashtimin e ndërlydhësit TAP AG nga kërkesa të caktuara, sipas direktivës 2009/73/EC, nga Autoriteti Rregullator i Energjisë i Shqipërisë”; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 8.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 129/6 prot., datë 6.10.2021 nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi “Miratimin e kërkesës së subjektit “Depa Commercial” s.a., për aplikim në TAP AG, për fazën jo të detyrueshme në treg - testi i TAP AG”,

konstatoi se:

- “Depa Commercial” sa paraqiti në ERE “Kërkesën për aplikim nga “Depa Commercial” s.a. për fazën jo të detyrueshme në treg - testi i TAP AG, në përputhje me nenin 4.7, pika 9, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, dhe direktivën 2003/55/EC, e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 26 janar 2003, lidhur me rregullat e përbashkëta në tregun e brendshëm të gazit natyror.

- TAP AG, sipas neneve 4.1, pika 7 dhe 4.7, pika 2, 6 dhe 9, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, është e detyruar të plotësojë kërkesat për kapacitetin detyrues/lidhës të cilat rezultojnë nga çdo testim tregu.

- Referuar njoftimit të fazës jodetyruese për testin e tregut TAP AG 2021, kërkesat nga palët e interesuara për lidhjet/kapacitetet jodetyruese duhet të paraqiten në TAP AG deri më datë 11 tetor 2021.

- Faza jodetyruese e testimit të tregut, për vitin 2021, nga Gazsjellësi Trans Adriatik ka filluar në 12 korrik 2021. Testi i tregut duhet të kryhet në përputhje me udhëzimet e miratuara bashkërisht me autoritetet rregullatore italiane (ARERA), greke (RAE) dhe shqiptare (ERE);

- “Depa Commercial” s.a. shprehet se është në fazën paraprake jo të detyrueshme të përcjelljes së aplikimit/kërkesës për fazën jo të detyrueshme, për lidhjen dhe kapacitetin e gazit natyror pranë shoqërisë TAP AG.

- Kërkesa për aplikim nga “Depa Commercial” s.a. është në përputhje me parimet e përmendura në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, si të përcaktuara në paragrafin 4.7 të tij, njoftimin e fazës jodetyruese për testin e tregut TAP AG 2021, në përputhje me udhëzimet për testin e tregut të 2021-shit, të Gazsjellësit Trans Adriatik, “Kodin e rjetit për mekanizmat e alokimit të kapacitetit”, legjislacionin evropian dhe kombëtar për kapacitetin rritës të transmetimit të gazit, ERE nuk ka kundërshtime për këtë kërkesë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Kërkesën e subjektit “Depa Commercial” s.a. për aplikim në TAP AG, për fazën jo të detyrueshme në treg - testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti